



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë **1 (një) Specialist në Sektorin e Finances dhe Kontabilitetit të Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar**, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsimit i lartë, profil Ekonomik. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Preferohet eksperiencë pune;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Njohuri mbi rregullat dhe procedurat e thesarit.;
- Njohuri shumë të mira të kontabilitetit dhe llogarive, sidomos në sektorin publik;
- Njohuri mbi mënyrën dhe strukturën e përgatitjes të pasqyrave financiare
- I aftë të punojë në grup
- Aftësi të mira komunikimi.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë në gjuhën shqipe, dokumentat e mëposhtëm:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV)
3. Diplomën/at e arsimit të lartë të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Formulari i vetedeklarimit të gjendjes gjyqësore (<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU”Nënë Tereza” duke nisur nga data **18.05.2022 ora 08:00** deri më **01.06.2022 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE